

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 452,  
DATË 11.07.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE ‘PËR  
LENDFILLET E MBETJEVE’”, TË NDRYSHUAR\***

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË  
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Në kuadër të përditësimit të direktivave evropiane, propozohen disa ndryshime dhe shtesa në VKM ekzistuese me nr.452, datë 11.07.2012 “Për lendfillet e mbetjeve”. Ndryshimet e sugjeruara lidhen me vendosjen e objektivave të reja në përputhje me direktivën 2011/97/EC, me direktivën e përditësuar evropiane 2018/850/EC si dhe me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Komëbtar të Veprimit. 2020-2035.

Objekti i kësaj Direktive është të parandalojë ose të pakësojë sa më shumë të jetë e mundur efektet negative në mjedis, në veçanti ndotjen e ujërave sipërfaqësorë, ujërave nëntokësorë, tokës, ajrit dhe shëndetit të njeriut si pasojë e trajtimit të mbetjeve.

Gjithashtu, për shkak se mercuri metalik kërkon vëmendje të veçantë lidhur me kërkesat e monitorimit, inspektimit dhe emergjencat si dhe përbërjen që duhet të ketë, është rishikuar aneksi II dhe V, duke bërë pjesë përbërëse të tyre këto kërkesa. Gjithashtu është shtuar një aneks i ri, aneksi VI që përmban pikat e nevojshme që duhet të ketë plani i zbatimit dhe konkretisht informacionin lidhur me shkallën e riciklimit, depozitimit në lëndfill, zbatimit të planit dhe programeve të menaxhimit të mbetjeve, financimit në zbatim të parimit “ndotësi paguan”.

Ndryshimet e propozuara në këtë draft të cilat transpozojnë kërkesat e direktivave 2011/97/EC si dhe 2018/850/EC, jo vetëm rrisin shkallën e përputhshmërisë së direktivave evropiane në legjislacionin shqiptar por edhe përmirësojnë kërkesat e legjislacionit për të qenë më e zbatueshme nga palët e interesuara.



## II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2022, në katërmujorin e II të këtij viti. Ky projektakt është bashkëpropozim i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

## III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Propozimi i këtij drafti me disa shtesa dhe ndryshime në përmbajtje të tij vjen si rezultat i direktivës së re evropiane të miratuar në vitin 2018 si edhe për të përditësuar afatet dhe objektivat në përputhje me objektivat e dokumentit të politikave strategjike të menaxhimit të integruar të mbetjeve, 2020-2025.

Ky projektakt ka si qëllim të rregullojë jo vetëm objektivat në përputhje me ato të përcaktuara në strategjinë e mbetjeve por edhe të vendosë përbërjen që duhet të ketë mercuri metalik, përmbajtjen që duhet të ketë konteineri që përdoret për ruajtjen e merkurit metalik, kërkesat e monitorimit, inspektimit dhe emergjencave për merkurin metalik.

Miratimi i ndryshimeve të propozuara, jo vetëm që do të rrisë shkallën e përputhshmërisë së direktivave evropiane në legjislacionin shqiptar por edhe do të përmirësojë kërkesat e legjislacionit për të qenë lehtësisht e zbatueshme nga palët e interesuara.

## IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit mjedisor me *acquis*, Republika e Shqipërisë ka miratuar së pari, ligjin nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, i cili veç të tjerash, përcakton edhe kategoritë e lëndfilleve, llojet e mbetjeve që mund të asgjësohen

---

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.452, datë 11.07.2012, të Këshillit të Ministrave ‘Për lëndfille të mbetjeve’”, të ndryshuar



tek secili prej lendfilleve dhe llojet e mbetjeve që nuk mund të asgjësohen në lendfill. Pra, projektvendimi i paraqitur është në përputhje me ligjin nr.10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar. Projektvendimi, është në përputhje edhe me nenin 100 të Kushtetutës.

Gjithashtu ky projektakt është në përputhje me objektivat e përcaktuara në VKM nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035".

#### V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky vendim përfron direktivat 2011/97/EC dhe 2018/850/EC.

#### VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projekt vendimi i propozuar ka parashikuar ndryshime të kreut XII të VKM 452/2012 "Për lendfilllet e mbetjeve", i ndryshuar. Konkretisht, është ndryshuar gjithë përmbajtja e pikës 34, ku afatet janë harmonizuar me përmbajtjen e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, 2020-2035.

Pas pikës 34, të kreut XII të shtohet pika 34/1 dhe 34/2 ku të parashikohen afatet për arritjen e objektivit të përcaktuar në pikën e mësipërme, 34/ç.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, është institucioni që grumbullon të dhënat e mbetjeve që gjenerohen çdo vit nga njësitë e vetqeverisjes vendore që do të ndihmojnë për të mbajtur në monitorim arritjen e objektivit të pikës 34/ç.

Në aneksin 2 të vendimit ekzistues është parashikuar shtimi i kërkesave specifike për merkurin metalik dhe konteinerëve që do të mbajnë merkurin.

Gjithashtu parashikohen disa ndryshime në aneksin V lidhur me procedurat e kontrollit dhe monitorimit në fazat e operimit dhe kujdesit pasmbylljes për merkurin metalik si dhe shtimin e një aneksi të ri, aneksi VI lidhur me planin e zbatimit që do të hartohet sipas shkronjës "b", të pikës 34/1.

#### VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

---

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.452, datë 11.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për lendfilllet mbetjeve", të ndryshuar



Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohen:

1. Ministria Turizmit dhe Mjedisit;
2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit

### VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e këtij projekt vendimi kanë kontribuar strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Projektvendimi është bashkëpropozim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Drafti i propozuar do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si edhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

### IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk parashikon shpenzime shtesë buxhetore, pasi strukturat që do të angazhohen për zbatimin e këtij vendimi, janë aktualisht të ngritura dhe funksionale.

BASHKËPROPOZUESI

MINISTRI

Belinda BALBUKU



PROPOZUESI

MINISTRI

Mirëla KUMBARO FURXHI

